



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 34, datë 09. 10. 2012

**PËR
“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË
BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR LIDHJEN E KONTRATAVE
PARA NOTERIT”**

Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); nenit 39/1, pika 1 e ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, (i ndryshuar); pikës 1 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.97, datë 03.02.2008 për “Procedurat e privatizimit të banesave shtetërore”; dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.29, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e njësisë përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 për “Privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 për “Privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për qytetarët si më poshtë:

| Nr | ADRESA | EMRI MBIEMRI |
|-----------|---|---------------------|
| 1 | Rr: “Pjetër Budi”, nr.71, përballë ish-dispanserisë | Abdulla Muhedini |
| 2 | Rr: “Pjetër Budi”, nr.71, përballë ish-dispanserisë | Pashk Oroshi |
| 3 | Rr: “Pjetër Budi”, nr.71, përballë ish-dispanserisë | Ahmet Brovina |

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI